



Albania

SHTATOR Bruksel

Gazeta e komunitetit
SHQIPTAR të Belgjikës.
Le journal de la communauté
ALBANAISE de Belgique.
De Krant van de **ALBANESE**
Gemeenschap in België.



The Best Guide Books of Albania

ALBANIA GUIDE
ALBANIA GREEN & MOUNTAIN GUIDE
ALBANIAN TOURISM magazine

www.albania-guide.al
marketing@albania-guide.al

Komunitet

Shqipëria dhe shpëtimi i Hebrejve

Konferencë në muzeun hebre në Bruksel

Opinion

Why you must visit Albania

Eliza Dushku

Kulture

Piccola guerra perfetta

Récit d'une guerre qui a eu lieu

Safet Kryemadhi

Dossier

De juro:
Albert Ajnshtajn ka qënë shtetas shqipëtar

Marekting

Albania praktike, çdo gjë që ju duhet e gjeni në: f.8 & 9 & 16

Botues: Albania; **Drejtoreshë :** Elona Zhana
Bashkëpunëtorë: Sakip Skepi, Eden Babani, Jeton Kelmendi,
 Elhame Gashi, Ermal Bytyci, Grisela Kaleshi,
 Edona Bytyci, Erodita Zhana, Asllan Krasniqi
 www.albaniainfo.be; journal.albania@gmail.com; Tel.: 0032.28301401

■ Turizem Eliza Dushku

Why you must visit Albania

Having the opportunity to travel the world through out my life, I've been to a number of wonderfully exciting places. After visiting 15 unique cities on my most recent trip to Albania (and acquiring dual-citizenship), I wanted to share my experience.

I'm an Albanian-Danish-American from Boston. Those who know me, know that I take great pride in being a Bostonian. However, I have always been curious about Albania and fascinated by my mysterious "orphan" country, one that was hardly ever spoken of. My father, Philip, was raised in the multicultural Boston South End, by parents George and Villermini Dushku, who immigrated to America by boat from this small Balkan country in the early 1920's. I never knew these grandparents. They passed on before I was born. I never had strong feelings of attachment to Albania nor to the small city of Korce where they were from but the feelings grew with me. Here is the story.

As I began to garner attention in my acting career, Albanians quickly began to take notice that one of their own was rising in the entertainment world... rare, and I was not a Belushi! Even earlier, someone around home

would look at me and say, in an accented voice, "You are Albanian!" And another time the whole family went to see the Italian-Albanian film *l'Amerika*. When the camera slowly panned over the deck of an old freighter crowded with Albanian immigrants I saw in the close-ups faces very much like my father's, my brother's, and myself.

My first invitation to travel to Albania came in 2004, when I was approached by a well-known Albanian-American photographer, Fadil Berisha, after he tracked me down in New York City where I was performing in an Off-Broadway play. Fadil is



currently the official photographer for Rolex, Miss Universe, and Miss USA. He has shot for *Elle*, *Vogue*, *Mademoiselle*, etc. and is very famous amongst Albanians for his vast advocacy work. He told me that my grandparents' "Mother Land" had been calling for me, that I had become

somewhat of a national heroine and that he wanted to bring me "home" for a visit. My father, two brothers and I obliged, and our first trip to Albania was both fascinating & exciting. I've seen few places as beautiful as Albania -- located across the Adriatic and Ionian Seas from the heel of Italy -- the country that *Lonely Planet* named the 1 travel destination for 2011 -- but is also known for its prideful isolation and two full generations of Communism in its belly. Upon returning home to the United States, I felt something deeper than my initial curiosity. I wanted to "understand" Albania, to try in some way to capture and share the experience we had, the connection we found, with the rest of the world. The idea to make a documentary film about Albania promoting tourism & travel to the country was conceived by Fadil Berisha, my brother Nate Dushku and myself. Once we talked about the film, it had to be done. It became a labor of love. We have been calling it our "Love Letter to Al-

bania." Little did I know, I would return home a dual-citizen of the country.

Now, looking back at the recent weeks we've spent there, I feel foolish for anticipating I could understand Albania in less than a life time, but the process has been exciting, and at the same time humbling.

I can only begin to explain the diversity I found once I tried to take in more than the fabulous beaches, the fascinating mountain villages -- each with its own hundreds of years of stories to uncover. It is an adventure that I am reveling in, realizing that I will go back many more times and still feel superficial saying that at last I understand Albanians.

One could say the same things about Italy, Greece, and Croatia, as those who have been to these richly historic, yet presently exquisite places will attest. Some might begin with a tour ship that ports at different islands, known



for black sand beaches or volcanoes -- but if you linger at any place, you discover new and powerful meanings. When I was a little girl during my first trip to Greece, we woke up in a tiny village and walked across the street for breakfast not knowing that we deeply offended our host family by choosing the restaurant on the wrong corner. We unknowingly entered into a dispute going back to the inter-war period between fascists and communists. When we asked how this could still matter, we found that to our friends it was as if it happened yesterday. Blind tourist? Or the beginning of a big lesson that came back to me as I sat on a rock on an Albania beach and looked up at an ancient ruin on the mountainside. I knew there were stories to be found, if I could find the right people.

Out of the gate we were determined to make our Albania documentary sleek, stylish, colorful and cinematic. The project would incorporate brazen personalities, stunning imagery and cultural touchstones such as food, music, fashion, sports and nightlife, all the while managing to touch upon Albanian customs and the environmental, socio-economic, and political issues facing the country today. My taste for adventure would set the tone for a fast-paced vacation, which indeed it was. As we forged through town and country, basking in the sunshine



of natural beauty and feeding off the energy of the Albanian people, we could relish the contemporary night spots and sexy boutiques, but we couldn't help wanting more. We stormed the vivacious capital city of Tirana and then the beach towns and islands of the Albanian Riviera, traveling up to the rugged villages of the Albanian Alps and over the border to Macedonia,

and to the city of Pristina, the youth-driven capital city of the disputed country of Kosova, all inhabited primarily by Albanians. My travel companions were -- my brother Nate, my boyfriend Rick Fox, our three-man American crew, and an exuberant Albanian entourage of additional cameramen, kind guards, planners and helpers. Luckily our guide was my beloved friend Fadil Berisha, also cousin to Albania's Prime Minister Sali Berisha which helped in providing access to governmental, media, and social outlets throughout the country. We stopped in 15 cities, every spot we savored, and left hungry for more of what we had taken in.

"It gets under your skin." My "Albanian-ness" goes deeper as I spend time there. The more often I go, the more I realize there is more to the story. There are so many stories to tell -- most are full of a kind of ancient mystery that requires a wider and deeper lens. I did feel something quite different on this trip to the "Home Country." After countless conversations with open and passionate people who feel deep ties to Albania, for the first time I could imagine saying that "I know what it feels like to be Albanian."

I am coming to understand the complexity of the mixture of pride and sadness over what so many have lived through, or heard repeated in their tender youthful ears by those they loved, about the triumphs and the defeats this nation has experienced -- as individuals and as a community. Thus, when I was generously invited to become an Albanian citizen, I felt no reluctance. I felt honored and able to accept this gift. I felt even more like who I am. I retain, of course, my American citizenship. I am that, too.

But it is no stretch for me to proclaim that as of August 17, 2011, I, Eliza Patricia Dushku, am an Albanian-American.

■ Aktualitet Edona Bytyci

Ambasada e Maqedonisë në Belgjikë feston madhërisht 20 vjetorin e pavarësisë



Me datën 08 shtator u mbajt në sallat e muzeut të armeve të Brukselit festa e 20 vjetorit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë.

Evenimenti u realizua nën përkujdesjen e Ambasadës së Maqedonisë pranë mbretërisë së Belgjikës.

Zgjedhja e sallës së muzeut kombëtar të armëve ishte po ashtu mjaft domethënëse në mesazhin e përcjellë me rastin e 20 vjetorit të pavarësisë. Mes të ftuarve të shumtë ishin prezent personalitete nga fusha e diplomacisë maqedonase si dhe asaj vendase belge. Sigurisht që nuk mungonin edhe shumë të pranishëm nga radhët e komunitetit maqedonas në Belgjikë.

Nga komunitetet e tjera mund të përmendim po ashtu përfaqësues të komunitetit shqiptar si dhe përfaqësitë diplomatike përkatëse.

Fjala përshëndetëse u mbajt nga Shkëlqesia e tij, Z. Muhamed Halili Ambasador i Republikës së Maqedonisë pranë mbretërisë së Belgjikës. Z. Halili u drejtua të pranishmeve në frëngjisht. Ai u shpreh se: "festimi i pavarësisë është një ngjarje e një rëndësie të veçantë për çdo popull por për Republikën e Maqedonisë është tejet e rëndësishme sepse kjo u arrit në mënyrë paqësore atëherë kur flakët e tmerret e luftës digjnin e shkatërronin pothuajse të gjitha republikat e tjera të ish federatës Jugosllave."

"Republika e Maqedonisë, -vazhdoi ai- në atë kohë ishte shumë e dobët, e bllokuar dy herë ekonomikisht një herë nga Jugu dhe një herë nga veriu, e neglizhuar nga gjeopolitika rajonale e megjithatë ajo ecte me kurajë drejt rrugës së prosperitetit ekonomik, politik e kulturor. Sot ajo është bërë një vend i prosperë që përballet me sfidat e kohës siç janë kundër efektet e globalizimit, kriza ekonomiko-financiare botërore si dhe papunësia. Ajo është bërë simboli i një vendi me harmoni dhe tolerancë ndërkulturore, tolerance fetare si dhe tolerance ndëretnike.

Falë përpjekjeve të shtetasve të saj si dhe falë përkrahjes së bashkësisë ndërkombëtare, mbështetjes së popujve e vendeve tuaja, Republika e Maqedonisë është shndërruar në një vend prospere, kandidat për anëtar të NATOS dhe EU, vend aktiv në zhvillimet për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në mbarë botën"- e mbylli fjalën e Shkëlqesia e tij, Z. Muhamed Halili.

Ndërkaq mbrëmja vazhdoi me muzikë tradicionale maqedonase dhe koktel, gjë që u dha rastin të pranishmeve të shkëmbejnë urimet mes tyre. Hareja e tingujt festiv të përziera me bisedat e pasura multikullore të të ftuarve duket sikur donin tu bënin të qartë armëve të shndërruara në objekte të muzeut që periudha e tyre duhej përfunduar.

■ Aktualitet Halit Elshani

Në mbrojtje të Ramush Haradinajt, kërkesë Këshillit të Ministrave të Parlamentit Evropian në Bruksel

Mërgata shqiptare në mbretërinë e Belgjikës organizoi me datën 17 gusht një protestë para Parlamentit Evropian në Plac Shuman, me moton Liri –Drejtësi për çlirimtarët. Tubimin e udhëhoqi drejtori i radios shqipe të kryeqytetit të Valonisë z. Memed Ali nga Namyri. Fjalën e rastit e paraqiti veprimtari i njohur z. Milaim Ziberi.

Gjatë këtij tubimi Këshilli i mërgatës shqiptare të Belgjikës lidhur me të drejtat e shqiptarëve në Ballkan kërkon nga Gjyqi ndërkombëtar me seli në Hagë të drejtën për lirim dhe çlirimtarëve nga aktakuat e montuara. Kjo kërkohej në bazë të Rezolutës ndërkombëtare dhe legjislacionit evropian.

Drejtuessit e tubimit ju drejtuan të mbledhurve me këto fjalë : Të nderuar zonja e zotërinjtë ministra të Parlamentit Evropian,

■ Aktualitet

Albana Berisha nga Kosova zgjidhet “Miss Bruxelles 2012”



Ajo u zgjodh vajza më e bukur e Brukselit, duke u bërë kandidate për pjesëmarrje në “Miss Belgjika 2012”. Vajza 21 vjeçare me origjinë nga Kosova arriti të triumfojë para dhjetëra bukuroshëve belge. Ajo u zgjodh si vajza më e bukur e Brukselit duke u bërë kandidate për pjesëmarrje në “Miss Belgjika 2012”. Në një intervistë për televizionin “7 sur 7”, Albana ka deklaruar se ishte e lumtur që ka arritur të sfidojë në këtë garë bukurie dhe se kurrë nuk kishte menduar se do të jetë e para. Spektakli u mbajt në kështjellën Birgminham të qytetit Anderlecht. Organizatori Severine Vandeghinste ka shpjeguar se Albana posedon trupin, buzëqeshjen dhe artin e një “Miss” dhe nuk është çudi nëse kjo fiton edhe Miss Belgjika,

Protestë para Parlamentit Evropian në mbrojtje të Ramush Haradinajt



Demostruesit pra Parlamentit Evropian-Schuman-Belgjikë

Ne, shqiptarët e Mërgatës në Belgjikë të ardhur nga viset e ndryshme të Shqipërisë së copëtuar padrejtësisht nga fuqitë e mëdha evropiane jemi tubuar këtu për të protestuar dhe për të reaguar me zërin e arsyes kundër padrejtësive dhe diskriminimit sistematik ndaj çlirimtarëve të lirisë në krye më

■ Humor Anonimus

Të dashur lexues. Do të doja të prezantohem shkurt me ju. Jam një gazetar shqipshkruar dhe jam kontaktuar nga gazeta Albania për bashkëpunim. Më është kërkuar të përmirësoj lexueshmërinë e gazetës me kushtet e mëposhtme :
-Ndalohet politizimi i gazetës
-Ndalohet kronika e zezë
-Ndalohet diskriminimi apo persekutimi moral i një personi.
-Ndalohen artikujt e teksteve erotike. Me një fjalë ndalohen të gjitha gjërat interesante, e për ne ballkanikët që i kemi qejf thashethemet. U thashë atyre të gazetës që një kontratë e tillë deontologjike është vetëvrasje në kushtet e sotshme të tregut, me të gjithë prurjet e shumëfishuara të informacionit.

Mu përgjigjen që qëllimet e Albanias janë më fisnike. S’kam gjë kundër fisnikërisë por më pëlqen shumë shprehja e një mikut tim « s’mund të jesh fisnik po pate barkun bosh » Nejshe, puna e tyre. Unë desha të ju në dijeni që do të jemi bashkë në çdo numër të Albania-s po shpëtova pa probleme. Çdo radhë në rubrikën time do të ketë një portret nga personazhet e komunitetit. Portretizimi do të bëhet në mënyrë humoristike, (nuk është e thënë që të dhënat të jenë të pavërteta)

gjeneralin e UÇK-ës Ramush Haradinaj, të cilët po mbahen padrejtësisht në Hagë.

Andaj me rastin e rigjykimit nga ana e Gjykatës së Hagës të Ramush Haradinaj, Lahi Ibrahimit, Idriz Bala, shprehim keqardhje që institucionet ndërkombëtare po e barazojnë agresorin më viktimën.

Anonimus vs Sakip Skepi

Zgjedhja e personazhit do të behët në bazë të dhe rolit të tyre në radhët e komunitetit. Zgjedhja e personazhit të sotshëm ishte po ashtu një moment i vështirë. Meqë ata të gazetës ishin dakord në princip me idenë e rubrikës , portrete e humor mu duk interesante të ja filloja me njërin prej tyre. E udhës ishte të ja filloja me Elona Zhanën por ju e dini që të ne shqiptarët femrat kanë një status të veçantë e të nxjerr zoti në telash, le pa që kam dëgjuar që ka edhe një vëlla të vështirë. I dyti në radhë mu duk rast i volitshëm. Pastaj gjithë kësaj vere dhe para saj këtë vit ka qenë nën dritat e projektorit, si bën gjë pse të merrem dhe unë pak me thashetheme për të.

Sakip Skepi, ka lindur diku nga shekulli i kaluar andej nga veriu i Shqipërisë. I vogël fare është larguar nga vendlindja për tu instaluar në ish Jugosllavi, sipas përlllogaritjeve i bie të ketë qenë pothuajse 4 vjeç por kur bisedon me të në lidhje me ikjen, të tregon me hollësi çdo detaj gjë që krijon konfuzion. Në Maqedoni jeton një pjesë të jetës së tij fëmijërore për të mbërritur më pas në Belgjikë.

Jemi të bindur se lufta për çlirim e një populli të okupuar është legjitime dhe se UÇK-ja nuk i ka shkelë rregullat Ndërkombëtare të luftës.

Kërkojmë :

-të veprohet drejt sepse jemi të bindur në pafajësinë e tyre,
-të ndërpritet arrestimi, keqtrajtimi dhe burgosja e shqiptarëve me skenarë të politikës serbe të mirëinskenuara,
-të lirohen nga burgjet serbe të gjithë të burgosurit dhe të dënuarit e pafajshëm,
-të ndërpritet arrestimet, burgosjet dhe maltretimet e çlirimtarëve dhe njerëzve të pafajshëm shqiptarë,
-të lirohen nga burgjet të gjithë të dënuarit e pafajshëm,

Në fund përsëndeti Ismet Haradinaj në emër të familjes Haradinaj, Halit Elshani në emër të bashkadhjetarëve më këtë rast ju dorëzoi organeve një peticion të firmosur nga të Milaim Ziberi, Halit Elshani dhe Riza Budakova.

Punon në fushën e financave, pagan sistematikisht kafet kur del në grup me miqtë. I pëlqejnë gjërat e bukura, si paratë, vajzat e bukura, kinemaja, kultura e sporti. Ka marrë pjesë në realizimin e dy filmave dhe është e pamundur që sa herë të flasësh me të, të mos tregojë diçka rreth kësaj. Aktualisht beqar, thotë se ka komplekse me femrat shqiptare. Fizikisht, është më i pashëm sesa e ka emrin , të cilin e ka pikë të ndjeshme. Është marrë edhe me politikë nëpërmes radios të cilën e drejton prej 25 vjetësh. I frekuenton pa problem si Doktorin, Nanon, Topin e të tjerët. Nuk është kurrë në orar, dhe nuk i bëhet vonë për shumë gjë. Miku më i mire i tij duhet të jetë telefoni, thuhet se flenë bashkë. Është shumë loyal në miqësi por pasionant dhe nganjëherë ekstremist. Kohët e fundit është zhdukur nga qarkullimi, ose ka rënë në dashuri ose është duke bërë para...

Në rast kontestimi të këtij shkrimi jeni të lutur të lani hesapet me redaksinë e gazetës.

Shqipëria dhe shpëtimi i Hebrejve (1929/1944) ishte kjo tema e konferencës që u mbajt me datën 13.09.2011 në Muzeun hebre në Bruksel.

Konferenca u drejtua nga Dr Patrice Najbor, doktor në shkencat politike si dhe këshilltar pranë oborrit mbretëror shqiptar, me zyrë në Paris. Me moderimin e konferencës u mor Sulejman Gjanaj Nënkrjetar i Partisë së Legalitetit. E menduar në kuadrin e rolit të luajtur nga Mbreti Zog për shpëtimin e hebrenjve nga holokausti, konferenca konsistonte në paraqitjen e një serie të dhënash e dokumentesh të përbëra kryesisht nga dëshmi. “Është shumë pak e njohur prej historianëve, madje edhe prej hebrenjve vet, dhe akoma më pak nga publiku i gjerë, fakti që mbretëria Shqiptare u ka sjellë një ndihmë të rangut të parë hebrenjve që kërkonin të largoheshin nga regjimi nazist me ardhjen në pushtet të Hitlerit me 30 janar 1933”. – është shprehur në hapje të diskutimit të tij, Dr Najbor.

“Diplomacia shqiptare – vazhdoi ai, në fakt i është kundërvënë doktrinës naziste në lidhje me hebrenjtë duke u mobilizuar për tu ardhur në ndihmë atyre që ishin të persekutuar në Gjermani, Austri apo edhe në Evropën Lindore. Që nga 1929 gjejmë në arkivat e mbretërisë së Shqipërisë kërkesa të hebrenjve që dëshirojnë të kenë nënshtetësinë shqiptare. Dhe që nga viti 1930 vejmë re që hebrenjtë cilët deklarohen me nënshtetësi shqiptare, mbërrijnë në Greqi dhe më saktësisht në Selanik. Një vit më vonë, vërejmë që disa hebrenjtë do të zbarkojnë në Durrës me datën 15 gusht 1931.

Por duke filluar nga viti 1933 numri i hebrenjve që dëshirojnë të bashkëngjiten mbretërisë shqiptare me qëllim që të përfitojnë nga mbrojtja e mbretit Zog që siguronte mikpritje për hebrenjtë e persekutuar, shtohet konsiderueshëm. Aty nga fillimi i viteve 30 gjejmë një shkëmbim korrespondence që mban datën 12 shkurt 1934 korrespondence kjo mes Nathan Allalouf et Mihal Sherka drejtor i agjencisë së shtypit të mbretërisë shqiptare që parashtron nevojën e hapjes së një konsullatë shqiptare në Tel-Aviv ; një letër nga Komisioni i Lartë i Refugjatëve të Ligës së Kombeve , James Mc Donald, i datës 29 shtator 1934, ministrit të punëve të jashtme , ku i kërkon

■ Aktualitet Elona Zhana

Shqipëria dhe shpëtimi i Hebrejve Konferencë në muzeun hebre në Bruksel

lejen për të vendosur emigrantë hebrenj me shtetësi gjermane ; Një tjetër kërkesë nga komiteti qendror i emigrantëve hebrenj të Gjermanisë ku kërkohet azil për persona të besimit hebre si dhe plot dokumente të tjera.

Marrëdhëniet miqësore ekzistojnë ma personalitete hebrenj si profesor Stanislav Zuber, , shkrimtarin Lëo Mathia, artistin Joli Jakob, por edhe biznesmen-in Leo Eton që e ka vizituar Shqipërinë i shoqëruar nga John Walter, djali i redaktorit të gazetës « Times » për të ekzaminuar në terren mundësinë e vendosjes së një kolonie. Projekti i vendosjes së kolonive hebre në Shqipëri, nëpërmes Komisioni i Lartë i Refugjatëve të Ligës së Kombeve, ka qenë i diskutuar gjerësisht në vitet 1933-1935 me mbretin Zog për konkretizimin e vendosjes së mijëra hebrenjsh që largoheshin nga Gjermania naziste.

Në 1934 mbretëria shqiptare i përgjigjet pozitivisht kërkesës së Komisionarit të Lartë të Refugjatëve të Ligës së Kombeve, James Mac Donald, për të pritur një numër të caktuar hebrenjsh. Pranohet që mbretëria shqiptare ka pritur rreth 500 familje herbe në akord me Ligen e Kombeve dhe nën ndikimin direkt të mbretit Zog i cili dëshironte të mbronte dinjitetin human të atyre që vuanin nga pushtimi nazist. Konstatohet që duke filluar nga viti 1935, intensifikimi i numrit të hebrenjve që emigronin në Shqipëri. Në dhjetor 1938, senatori amerikan Robert Reynolds viziton Shqipërinë për të vlerësuar kontributin që bashkësia hebrenjve e USA duhej të sillte për të mbuluar shpenzimet e 500 familjeve hebre të vendosura në Shqipëri. Ambasadori i Shqipërisë në USA, Faik Konica ishte në diskutime me komitetin hebre të shtetit të Nju Jorkut për të shifruar nevojat e rastit.

Po ashtu gjinden shumë shënime të konsullatës italiane në Shqipëri në lidhje me aktivitetet e hebrenjve në Shqipëri me emrat dhe përkrahjen

e sjellë

Vërejmë po ashtu, edhe qarkulloren e Ministrisë së Brendshme, të datës 6 shkurt 1939 në lidhje me urdhërin e dhënë misioneve shqiptare jashtë për të dhënë viza turizmi njëmuajore hebrenjve që dëshirojnë të shkojnë në Shqipëri, dhe qarkulloja e datës 27 shkurt 1939 që anonçon masat që duhen ndërmarrë për pritjen dhe vendosjen e hebrenjve në Shqipëri.

Qeveria italiane informon konsullatën shqiptare në Romë për mos pajtimin e saj në lidhje me vendosjen e hebrenjve në Shqipëri. Në një raport sekret që mban datën 16 qershor 1939, shërbimet diplomatike italiane informojnë qeverinë në Romë se aktivitetet dhe rëndësia numerike e kolonisë hebre në Tiranë ishin të rrezikshme. Sipas këtij raporti vendosja e hebrenjve në Shqipëri ishte e inkurajuar nga legata amerikane. Raportuesi kishte arritur në konkluzionin që : Jo ngadalë por shpejt, hebrenjtë kanë fituar simpatinë e popullsisë lokale, që nuk është loyale, dhe që ka qenë edhe dashakeqëse kundra nesh ».

Mbreti Zog kishte autorizuar ministrin e punëve të jashtme shqiptare tu jepte pasaporta shqiptare hebrenjve të cilëve u kishte dhënë mikpritjen.

Gjinden po ashtu në arkiva prova që vërtetojnë që mbreti Zog u ishte përgjigjur pozitivisht kërkesave të cilat i ishin drejtuar personalisht si për shembull doktorit gjerman Martin Gotthilf, austriakut Richard Atlas, gjermanit Karl Kohen, profesorit Robert Kaulla dhe Hansi Roszaria, të gjithë të përzënë si pasojë e origjinës së tyre izraelite.

Historiani amerikan Bernd J Fischer shef i departamentit të historisë në Universitetin Indiana, që ka studiuar historinë e Hebrenjve shqiptarë gjatë periudhës zogiste dhe gjatë luftës së dytë botërore, flet për periudhën kur Shqipëria ka qenë nën drejtimin e Zogut (1925-1939) si një « moshë e artë » për hebrenjtë në këtë shtet. Komiteti hebre është njohur zyrtarisht me datën 2 prill 1937, pasi ishte integruar në një mjedis

tolerance fetare të frymëzuar nga mbreti Zog personalisht. Në fakt, shumë prej tyre kanë marrë edhe leje rezidence në mënyrë që të punojnë. Qeveria e Zogut jo vetëm ka marrë pjesë aktive për të shpëtuar këta hebrenj duke lehtësuar hyrjen e tyre në Shqipëri por edhe është kujdesur për mirëqenien e tyre në vend. Numri i atyre që e kanë përdorur Shqipërinë si një stacion kalimi , vlerësohet mes 600 et 3000 personash.

Bernd J. Fischer vlerëson që veprimet e mbretit Zog kanë lejuar që të shpëtohen rreth 2000 hebrenj por kjo shifër mendohet të jetë shumë më e lartë.

Në 2005 Muzeumi Memorial i Holokaustit ka identifikuar 2 640 hebrenj të shpëtuar në Shqipëri, po kjo listë është një «limitus minimum quam » sepse siç e shpjegon profesor Shaban Sinani, një numër i madh hebrenjsh nuk figuronin në këtë listë për tre arsye kryesore : e para është përdorimi i identiteteve të rreme ose regjistrimi i informacioneve të pavërteta , e dyta është konvertimi dhe së treti kemi ndryshimin e shtetësisë.

Sipas një analize tërësore të gjithë hebrenjve të Shqipërisë që janë shpëtuar nga lufta, vetëm 32 prej tyre janë dërguar në Kosovë. Nëse krahasojmë Jugosllavinë (duke përfshirë këtu Kosovën) përqindja e mbijetesës të popullsisë hebre ka qenë vetëm 18 gjer në 28% dhe në Greqi vetëm 14 gjer në 22% .

Në Shqipëri janë regjistruar shumë më shumë Hebrenj në fund të luftës sesa në fillim të saj nga fakti që njihet gjithandëj që Shqipëria ishte bërë një vend azili për ta. Në lidhje me këtë ambasadori i Shqipërisë në Francë Z Ferit Hoxha, ka deklaruar në pritjen e organizuar nga Ambasada për prezantimin dhe publikimin në frëngjisht të librit të shkrimtarit Neshat Tozaj (Ata nuk ishin vëllezër por ... Paris mars 2004) « Është i njohur shumë pak në botë fakti që gjatë luftës së dytë botërore asnjë hebre nuk ju dorëzua autoritete gjermane. Përkundrazi hebrenjtë shqiptarë u mbrojtën me gjithë rreziqet e njohura

Seminari Mbarëkombëtar për Mësimin Plotësues në Gjuhën Shqipe në Diasporë është veprimtari e lavdërueshme e dy ministrive tona të arsimit, asaj të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Republikës së Kosovës. Seminari i përvitshëm mbahet në kuadër të LASH-it (Lidhja e Arsimtarëve Shqiptarë) dhe të Shkollës Shqipe të Mësimin Plotësues (SHSHMP) "Naim Frashri", historiku i të cilave daton përpara më se 20 vjetësh. Nisma e asohereshme, me synim ruajtjen e identitetit kombëtar të fëmijëve që ndiqnin mësimet përkatësisht në gjuhën e vendit ku jetonin, dhe ngjallja tek ata e ndjenjës kombëtare dhe e dashurisë për vendlindjen, gjeti mbështetje të fuqishme në radhët e emigracionit shqiptar të disa vendeve të Evropës Perëndimore. Ajo u mbështet po aq fuqishëm si prej administratës së Qeverisë Bukoshi, në emigracion, ashtu edhe prej administratave qeverisëse të Kosovës së pasluftës. Vitet e fundit, për mbarëvajtjen e Seminarit, është angazhuar edhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës e Republikës së Shqipërisë, çka i jep veprimtarisë ngjyrim mbarëkombëtar. Do ta konsiderojë i domosdoshëm për të ardhmen një investim edhe më të madh të organeve përkatëse të Maqedonisë, ku etnia shqiptare katribute shtetformuese, ndërsa është fakt i pamohueshëm që fëmijë me shtetësi maqedonase, por me prejardhje shqiptare, ndjekin Shollat Shqipe të Mësimin Plotësues në vendet ku kanë emigruar. Për vlerat e Seminarit, është e tepërt të zgjatim. Sipas meje, ndërsa Rruga e Kombit ka zgjeruar dha ka çelikosur urat e afrimit fizik mes shqiptarëve të veçuar përdhun-

shëm dekada e dekada me radhë, veprimtari kësisoj hedhin ura të tjera afrimi shpirtëror, në interes të qasjes drejt çështjes sonë kombëtare ende të pazgjidhur. Po përjetojmë atë stad të zhvillimeve historike, kur, falë Rugës së Kombit, lëvizja e lirë këtej e andej kufirit zyrtar mes dy shteteve shqiptare është ngjitur në nivelin, ndoshta, më të lartë, si nga ana sasiore, ashtu edhe nga ana cilësore. Në kushte të tilla, cilësisht të reja, veprimtaritë arsimore e kulturore të përbashkëta, përfshi edhe seminarin në fjalë, janë shtysë për njësimin shpirtëror mbarëshqiptar. Në Seminar, morën pjesë mbi 120 arsimtarë të ardhur nga vende të ndryshme: Austria, Kanadaja, Finlanda, Suedia, Greqia, Zvicra, Gjermania, Italia, Belgjika, Anglia, Kroacia. Pjesëmarrja e delegacioneve nga Republika e Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës, si dy vende ku arsimit ynë zhvillohet mbi baza shkencore dhe kontrollohet prej shtetit, përvijoi kornizën e domosdoshme të zhvillimit të punimeve gjatë ditëve të Seminarit. **Programi katërditor ishte i pasur dhe i larmishëm, qoftë për tematikën, qoftë për nivelin shkencor të kumtesave të mbajtura.** Gjatë seancave plenare, lexuan kumtesat e tyre personalitete të shkencës dhe të arsimit nga Republika Shqipërisë dhe nga Republika e Kosovës, si: Akademik Vaso Tole: "Trashëgimia kulturore

■ **Emigracion** Eden Babani

Një seminar me vlera dhe me mbresa të



përmes njohjes konkrete të vlerave kombëtare"; Prof. Dr. Drita Statovci: "Veshjet dhe identitetet"; Prof. Dr. Dhimitër Doka e grupi: "Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë"; Prof. Ladi Shahini: "Rrënjët historike perëndimore të arsimit shqiptar"; Dr. Tomi Treska, i Universitetit European të Tiranës: "Pasqyrimi i rolit të diasporës në programet e historisë së popullit shqiptar në arsimin parauniversitar (klasa e nëntë dhe e dymbëdhjetë)"; Dr. Florim Isufi: "Kategori gjeografike të Atdheut në funksion të identitetit"; Dr. Ndrëçim Mehmeti: "Interpretimi historik dhe veçoritë e tij në programin e diasporës"; si edhe shumë kumtesa të tjera që sollën përvojën e drejtpërdrejtë të mësimdhënësve në kushte të veçanta të vendit ku jetojnë.

Me interes të veçantë u ndoq kumtesa e Dr. Katrin Hohman e Universitetit të Dyseldorfit – Gjermani: "Funksioni dhe rëndësia e mësimin të gjuhës dhe të kulturës së origjinës". Kumtesën e ndoqi puna e diplomës (me të njëjtën temë) e një studenti shqiptar në Universitetin e Dyseldorfit, e cila u shoqërua edhe me grafikët dhe diagramet përkatëse.

* * *

Siç thashë, programi i Seminarit ishte tepër i larmishëm. Organizatorët kishin menduar për gjithçka dhe me hollësi: që nga seancat e përbashkëta, deri te diskutimet me tematikë të ndryshme; që te darka e natës së parë, deri te kushtet e bujtjes; që nga promovimet e librave me interes për arsimin në diasporë ose të librave ar-

tistikë, deri tek ekskursionet jashtë Prishtinës. Darkën e mirëseardhjes e shtroi Kryetari i Prishtinës, zoti Isa Mustafa, njëherësh edhe Kryetar i LDK-së. Përhëndetja e tij na ngrohu zemrat në ato ditë të mbushura me episode të trishta në veri të Kosovës, bash në Mitrovicën tonë shqiptare, ndër të parat që është përballur me shovinizmin e egër serb dhe ndër të fundit që po përjetojnë ende të njëjtën egërsi. Në këtë kontekst historiko-politik, do ta konsiderojë, gjithashtu, vizitën dhe përhëndetjen e zotit Ramë Buja, Ministër i Arsimit i Shkencës dhe i Teknologjisë i Republikës së Kosovës, në një nga seancat plenare të ditës së tretë. Tryeza jonë e darkës së mirëseardhjes ishte e beгатë jo vetëm për menyne.

të padiskutueshme pashlyeshme



Foto: asllan.krasniqi@gmail.com

Atë e begatuan sidomos ata që rastësia i puqi bashaty. Të parët në atë tryezë, u rehatuan ne, delegacioni i Belgjikës: Kryetari ynë, Dr. Agim Syla, fotografi i kudondodhur, Asllan Krasniqi, mësuesi i pasionuar i muzikës, Shani Basha, dhe unë, gazetari. Na mungonte mësuesja e përkushtuar, Silvana Gjebreja, atë mbrëmje me dhimbje koke. Prof. Ladi Shahini, na u afrua sa na pa. Pas tij, çifti simpatik Tafilaku, Ismaili dhe Flutura, të cilët u ndoqën prej Alma Zekollarit, Marinela Naqos, Anila Kilës dhe Valbona Hustunës, një pjesë e delegacionit nga Greqia. Gjatë darkës, përveç të tjerave u promovua libri i autorit Dritan Gashi (Gjermani) “Këngë të paharruara shqiptare”, një përmbledhje tekstesh të bukura, klasifikuar sipas

brendisë së këngëve ose sipas kohës kur janë kënduar.

Pushimet për kafe mes ancave plenare ishin çaste të bisedave lënë përgjysmë mes të njohurish në seminaret e viteve të shkuara ose i njohjeve të reja. Ripërtëritja e kujtimeve ose shkëmbimi i adresave postare a elektronike, i numrave të telefonave, pse jo, edhe i librave mes autorësh të ndryshëm, vulosi dëshirën e secilit për të mos i humbur në të ardhmen lidhjet me shoku-shokun.

Të paharruara do të më mbeten në kujtesë ekskurSIONET e organizuara pasditeve me dy autobusë të vënë në dispozicion prej mikpritësve. Novobërda, një kala mesjetare në komunën me të njëjtin emër dhe pranë ku-

firit me Bujanovcin, është ndërtuar në lartësi përmbi 1100 m mbi nivelin e detit. Për fat të keq, në kala nuk është vënë dorë për mirëmbajtjen e saj gjatë regjimit pushtues jugosllav, ndonëse ajo duhet të ketë vlera historike e ndërtimore me mjaft interes. Kryetari i Komunës së Novobërdës, zoti Bajrush Ymeri, ka premtuar se, së shpejti, do të fillojë restaurimi i vlerave të saj. Komuna, na shpjegoi më tej ai, është e banuar në shumicë prej serbësh. Megjithatë dhe megjithëse pas lufte ajo është administruar në mënyrë alternative prej të zgjedhurve të dy etnive kryesore, serbëve dhe shqiptarëve, tri komunitet që e popullojnë, serbët, shqiptarët dhe romët, jetojnë pa probleme dhe në harmoni me njëri-tjetrin. Përballë kalasë, thujse në të njëjtën lartësi, ndodhet miniera që mban, gjithashtu, emrin e komunës. Për shfrytëzimin e saj, në kohën e pushtimit, punonin mbi 800 punëtorë. Minerali, i cili përmban edhe sasi ari, transportohej me teleferikë të fuqishëm poshtë në luginë dhe, prej andej, evadohej me kamionë në drejtim të Serbisë. Bajrush Ymeri mendon se, tashmë, duhet ndërruar emri sllav i minierës, ndoshta edhe i komunës që drejton. Emri shqiptar “Artana”, ndoshta me prejardhje ilire, do të ishte më i përshtatshëm sesa Novobërdë, për shkak se ndodhet në vise historikisht shqiptare dhe për shkak të arit që përmbajnë ato lartësi. Një “fotografi e familjes” nën kala, e shkrepur nga dhjetëra aparate, do t’i jepte fund ekskurSIONIT, njëherësh edhe ditës së gjatë të punës. Pasdarka na mblodhi në sallën e madhe të mbledhjeve plenare. Kënduam të gjithë bashkë, shoqëruar

prej këngëtarit të njohur kosovar, Osman Shehu, Një detyrim familjar dhe largimi i parakohshëm prej Seminarit, më hoqi të nesërmen mundësinë e vizitës në “Shpellën e Mermerit”, në Gadime, siç më kanë thënë, një mrekulli e natyrës

Ma ka ënda ta përsëris: Seminari është veprimtari e lavdërueshme e dy ministrive tona të Arsimit. I sivjetshmi, nën drejtimin e dy specialistëve të përkushtuar, Nuhi Gashi (Prishtinë) dhe Besnik Rama (Tiranë) do të mbahet mend qoftë për organizimin e përkryer, qoftë për tematikën e larmishme, qoftë për përpikërinë e zbatimit të programit, qoftë për shfrytëzimin e mundësive që japin teknikat elektronike në shoqërimin e kumtesave me foto, grafikë a diagrame, qoftë për hapësirat mikpritëse që iu krijuan delegatëve. Por, nëse çka u kumtua e u diskutua gjatë ditëve të Seminarit do të mbetej në mjediset e Hotelit Emerald, i gjithë mudi dhe përkushtimi i delegatëve do të shkonte dëm. Tashmë, arsimtarët e Shkollës Shqipe të Mësimin Plotësues do të presin, me të drejtë, pasqyrimin e përvojave të shkëmbyera për hartimin e programeve dhe të teksteve të njësuara për të gjitha shkollat që funksionojnë në Diasporën Shqiptare. Është detyrë e ministrive përkatëse të gjejnë dhe të vënë në dispozicion fondet e nevojshme, pse jo, të mendojnë edhe për shpërblimin, sado simbolik, të arsimtarëve, deri sot, vullnetarë. Me një llogari të thjeshtë, duke mbajtur parasysh numrin e madh të shqiptarëve që jetojnë në emigracion, del se mijëra fëmijë, po të ishin në vendlindje, do të ulëshin në klasat e përkatëse si qindra-mijëra të tjerë, duke shtuar numrin e mësuesve me pagesë.

Në kushtet e emigracionit, ata presin përkujdesjen e vendeve nga

kanë emigruar, që të mos e humbasin gjuhën dhe që të ruajnë identitetin kombëtar. Dhe të mos harrojmë se brezi i tyre është pasuria më e madhe që do të trashëgojë kombi ynë në të ardhmen.

Në Seminar, u vërejt edhe ndonjë mangësi e vogël që, sipas meje, nuk duhet anashkaluar. Do të ishte e domosdoshme, fjala vjen, që kumtesat e lexuara të ishin shumëfishuar praktikisht dhe të ishin vënë në dispozicion të pjesëmarrësve. Kjo do ta shtonte në një masë të madhe përvetësimin e ideve të lektorëve prej auditorit dhe do të nxiste pyetje e diskutime me vlerë. Nuk më rrihet pa vënë në dukje edhe ndonjë pakujdesi gjuhësore në rastet e paraqitjes së lëndës së përmbledhur në ekranet ballore. Në cilin paragraf të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe është gjetur “rregulli” i shkrimit me shenjën e fraksionit, për të treguar njëherësh të dyja gjinitë, mashkulloren dhe femëroren? Më se një herë ranë në sy gabime drejtshkrimore të tilla si mësuesi/ja ose mësuesit/et etj. në vend të mësuesi e mësuesja, mësuesit e mësueset etj., siç e kërkon natyra e gjuhës sonë. Për fat të keq, kjo dukuri gjuhësore e gabuar po merr përmasa përherë e më të mëdha në shkrime të ndryshme, kinse ata që e përdorin, sjellin risi prej gjuhëve të huaja, ku, në kontekste të caktuara, edhe mund të jenë të pranueshme. Në një seminar me arsimtarë të kualifikuar nga ana profesionale, gabime të tilla do të ishin të papranueshme. Gjithsesi, pavarësisht ndonjë vërejtjeje, vlerat e Seminarit të sivjetshëm mbeten të lavdërueshme, kurse mbresat të pashlyeshme.

Dëshironi që për biznesin tuaj të bëni me dije 10 000 klientë të mundshëm ??? Gazeta Albania ju ofron të vetmen mundësi në Belgjikë.

Voulez-vous cibler 10 000 consommateurs potentiels ??? Le journal Albania vous offre cette possibilité.

Contactez

0032 476 39 49 23

Kontaktoni

COIFFURE
DEA
Gjocaj Muharrem



RUE ERNEST LAUDE 06
1030 BUXELLES (Schaarbeek)

INFO:
0479 57 17 95

GRUPI MUZIKOR "ARTI 3"
Per gazmende familjare:
DASMA, FEJESA,
DITE NUSNIJE,
SYNETIME, DITELINDJE,
e shume gazmende te tjera ku ju disponon:
Ilaz Prishtina &
Grupi "ARTI-3"



INFO: 0497 19 89 09
:0479 47 69 25

Radio Jehona e Shqipes
105.4 FM
Çdo të dielë
nga ora 15:00 - 17:00



Online: www.radiopanik.org

MISHTORE
SLAGERIJ
BOUCHERIE
KASAP **KOSOVA**
Enver Krasniqi - NELI

Specialitete shqiptare:
Mish, suxhuk, mish i thatë etj...

Shërbim i shkëlqyer
Çmime të volitshme
Tek ne dhe do të gjeni cilësinë!



Avenue Maréchal Foch 17
1030 Schaerbeek Bruxelles

Tel: +32 2 304 73 98 Gsm: +32 484 73 69 62

Alba Cars

Avenue Edouard Bénés 176
1080 Molenbeek-Saint-Jean
(Bruxelles)

Tel: 02 411 27 18
02 411 77 17
Fax: 02 411 24 13
albacar@skynet.be



ALBI MARKET

ALIMENTATIONS
FRUITS ET
LEGUMES

ALBI
MARKET

ARTICLES - MENAGERS
PRODUITS -
D'ENTRETIEN



NA VIZITONI DHE DO TE GJENI TEK NE PRODUKTE
NGA VENDLINDJA. VETEM E VETEM ALBI MARKET JU A
OFRON KETE MUNDESI. PARKING FALAS.

INFO:
02 / 218 01 17

ADRESA: RUE ROGIER 237
1030 SCHAERBEEK - BRUXELLES

ALL

ALBANIAN LANGUAGE SERVICES

Translations

ALBANIAN LANGUAGE SERVICES është një zyrë e specializuar për përkthime në **frëngjisht, hollandisht, anglisht dhe shqip.**

“**ALL TRANSLATIONS**” ju ofron shërbime të shpejta, nga përkthyes të betuar në këto gjuhë dhe çmime tepër të volitshme

Përkthejmë të gjitha llojet e dokumenteve

- Patenta
- Martesë
- Intervista
- Takime me avokatë
- Provime patentash makine etj

KONTAKT: 0476 39 49 23

■ **Diasporë** Ramiz Selimi

T'i hapen rrugët diasporës për të dhënë kontribut në zhvillimin ekonomik

Mërgimtarët kërkojnë përkrahje nga institucionet e shtetit.

Ka shumë vite që na mendojnë probleme e telashe të jashtëzakonshme të të gjithë mërgimtarëve nëpër kalime, udhëtime, viza e mundime të ndryshme. Përveç vuajtjeve, ngarkesave psikike, e brengave të varfërisë, ku secili nga ne mbanë familje në Kosovë, vëllezër e të afërm, mërgimtarët patën edhe vuajtjet tjera si nga vendet pritëse ashtu edhe nga ato tranzite. Shumë vite diaspora vuajti duke ndarë kafshatën e gojës për të mirën e vendit, shumë vite ajo bredhi rrugëve të Evropës duke demonstruar e duke aktivizuar të gjithë potencialin për interesa kombëtare. Disa shkuan vullnetarisht në luftë e disa derdhën shumë para në fondet e krijuara. Të gjithë ata që kanë emigruar edhe në Luftën e Dytë Botërore, nuk e harruan vatanin, kontribuuan secili në mënyrën e vet, vetëm e vetëm që ti dilet në ndihmë atdheut. Kurse tani nuk qanë kush hallin dhe dertin e tyre. Fjala bie tash, është nevoja për një lehtësim në regjimin e vizave të mërgimtarëve me vendet e Ballkanit. Ka kohë që vendet tranzite tallen me mërgimtarët tanë edhe pasi që jemi bërë shtet, po atëherë i kujt është ky shtet, nëse nuk kujdeset



për qytetarët saj? Ka raste kur disa herë duhet të shkohet në konsullata për të plotësuar formular për të kaluar tranzit, duke kaluar disa ditë poshtë e përpjetë.

Duke i kontrolluar me orë të tëra, duke i ndalur nëpër kolona me fëmijë e gra, duke ju shkuar pushimi nëpër zyra të ndryshme në vendlindje, duke vrapuar pas dokumenteve, letërnjoftimeve, certifikatave e shumë probleme tjera, për të mos ja shijuar aspak shijen e atdheut. Diku duke sharë korrupsionin, e diku duke kërkuar njeri që të kryej punë edhe me ryshfet. Mërgimtarët kanë të gjithë leje pune dhe qëndrimi në vendet ku punojnë, nuk meritojnë një trajtim të tillë as nga vendet tranzite, por as nga shteti amë. Bile, bile shteti i Kosovës duhet të jetë ai që lufton dhe i mbron qytetarët e vet, atëherë kur atyre ju bëhet një e padrejtë. Njerëzit për t'i shpëtuar këtyre vuajtjeve filluan të gjunjëzohen dhe shkuan e morën pasaporta serbe,

edhe sot ka njerëz që po i marrin ato drejt pasaporta, vetëm për të shpëtuar shpirtin nëpër kalime, jo pse e duan Serbin e të ja shohin sytë. Mendoj se qeveria e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë duhet të punojnë shumë më shumë, që shqiptarët mërgimtarë të kalojnë tranzit nëpër të gjitha shtetet ballkanike pa probleme. Është e pabesueshme që qytetarët tanë të pajisur me patentshofer të Bashkimit Evropian, janë vegël e përbuzjeve dhe maltretimeve në vendet tranzite. Mërgimtarët janë aq shumë të zhgënjyer dhe të mërzitur nga moskujdesi i qeverive tona, aq sa janë të ndezur e plotinate, kjo sjellje indiferente të bënë të ndihesh plotësisht i pambrojtur. Nuk është aspak befasisëse që një pjesë e tyre janë agresiv në kufi. Peripecitë e shumta gjatë udhëtimit i bënë ata të nxehën dhe të nervozohen, pasi që rruga për në atdhe duhet të jetë e hapur dhe pa probleme, pa telashe, në vendlindje

duhet të shkojnë me vullnet. Qeveria duhet të bisedojë me të gjitha shtetet fqinje, jo vetëm për tregti të mallrave, por pikërisht edhe për problemet e mërgimtarëve, në mënyrë që të lehtësohet ardhja në atdhe. Edhe miqve ndërkombehtar duhet t'u thuhet qartë që të intervenojnë të ato shtete që po hapin barriera. Duhet t'i hapen rrugët diasporës, këtij potenciali të madh e të fuqishëm ekonomik, që të ndihet plotësisht i dëshiruar për të dhënë kontributin e tij në zhvillimin ekonomik.

Të këputen përfitimet e matrapazëve e njerëzve të dyshimtë në aeroporte. Sikur të ndodhte lehtësimi i udhëtimit, ardhja në vendlindje do të dyfishohej, e në disa raste do të trefishohej. Ata që tani udhëtojnë dy herë, po të ishte bileta si në relacionin Vjen-Londër do të udhëtonin së paku katër herë në vit, paramendoni çdo ardhje e tyre do të rriste qarkullimin e mjeteve

financiare, do të ishte një ngritje shumë më e madhe në krahasim me këto që kemi tani. Numri i atyre që do të vizitonin atdheun do të rritej dukshëm, mjetet financiare do të mbeleshin në vendlindje dhe me këtë direkt edhe bizneset do të lulëzonin. Qeveria me një hapë të tillë do t'i ndihmonte zhvillimit ekonomik dhe bizneseve në përgjithësi. Ata që kanë përfunduar studimet në Biznes dhe Menaxhim e dinë që vendimet e vogla në dobi të kolektivit sjellin zhvillimin ekonomik. Të gjitha shtetet që po na sjellin probleme, njëkohësisht përfitojnë materialisht nga mërgata e jonë. Ministria e Diasporës që është krijuar tani, duhet t'i marrë shumë seriozisht të gjitha problemet e mërgimtarëve dhe assesit nuk guxon të jetë indiferente ndaj problemeve të tyre. Injorimi i tyre do të shkaktonte humbjen e një krahu shumë të fort, me emrin "Diaspora", krahu më të fort politik dhe ekonomik që ka Kosova.

Rrallimet e vizitave në atdhe do të ishin shumë të dëmshme dhe katastrofale për vendin. Të eliminohen maltretime nëpër kufij, të ndalohet plaçkitja e tyre nëpër rrugët e shteteve fqinje. Të eliminohet burokracia e tepruar e marrjes së dokumenteve në vendlindje. Kjo ndihmë është e nevojshme dhe e domosdoshme nëse pretendojmë të jemi shteti i civilizuar.

Eshtë alarmante situata, që po shihet në tërë diasporën tonë, mësuesit shqiptarë nuk e kanë përkrahjen e merituar nga ata që duhet ta përkrahnin, por pritet që do të bëhet më mirë. Edhe pse ishim të ftuar në kremtën e madhe, dhjetë vjetorin e shkollës plotësuese shqipe në Belgjikë dhe nuk mundëm të jemi prezent, me që kishim rezervuar për në Zvicër, e konkretisht në kantonin Argau për përfundimin e vitit shkollor në këtë pjesë të Zvicrës, por ne u munduam, që ti qëndisim disa fjalë modese, disa fjalë shpirti për ate organizim, të njoftuar nga kryetari i LASH-it për Belgjikë Dr. Agim Syla dhe me të parë fotot dhe nga informatat që i kemi pasur edhe më herët për punën që bëjnë mësuesit bashkë me veprimtarët në këtë shtet mik të kombit tonë, ne do ti japim disa pjesë shkrimi nga ajo ditë e madhe.

Sytë e fëmijëve ishin të qeshur, fëmijët mërgimtarë kërkonin dhe prisnin diçka dhe donin të thonin prap diçka, e kjo pyetje ishte, se a do punohet më shumë në të ardhmen për shkollën plotësuese shqipe, se përndryshe do na gjykojë historia dhe të mos trish-tohemi pastaj, që një nënë shqiptare ti flet fëmijës së tij frengjisht, gjermanisht apo italisht. Para pak ditësh në qytetin Sint-Niklaas të Belgjikës, me rastin e përfundimit të vitit shkollorë dhe 10 vjetorit të punës së shkollës shqipe në këtë qytet, u mbajt manifestim festiv, ku ishin mbledhur bashkatdhetarë nga të gjitha trojet shqiptare për të përcjellur këtë festë të madhe.

Falënderime për ata që kontribuan për shkollën shqipe në diasporë

Përpos një numri të madh të bashkatdhetarëve, manifestimin në fjalë e

■ **Komunitet Përgatiti: Besnik Hebibi**

Dhjetë vjet të shkollës në gjuhën shqipe në Belgjikë



nderoi edhe Nuhi Gashi, udhëheqës i shkollës shqipe me mesim plotësues pranë MASHT të Kosovës, Gani Azemi, këshilltarë në ambasadën e Kosovës në Belgjikë, (përsëriti takimin), Hidajet Çera, këshilltar në ambasadën e Shqipërisë, (përsëriti takimin), përfaqësues të partive dhe shoqatave shqiptare që veprojnë në Belgjikë. Në pamundësi për të marrë pjesë në këtë manifestim, kishte dërguar një shkresë, e cila edhe u lexua nga ministri i diasporës Ibrahim Makolli. Me një letër përsëritëse këtë mbrëmje e përsëriti edhe znj. Mimoza Halimi, Ambasadore e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nga musafirët belg morën pjesë si Karel Van Reeth nga Parlamenti Evropian, i cili edhe përsëriti të pranishmit me një fjalë rasti, Jef Foubert, ish kryetar i komunës së Sint-Niklaasit dhe drejtor aktual i Qendrës për Ndihma Sociale në këtë qytet, gjithashtu përsëriti të pranishmit, Daan Anthuenis, nënkryetar i komunës së Sint-Niklaasit Joke Maes, përgjegjëse për kulturë dhe bashkëpunim ndërnacional pranë kesaj komune, si dhe musafirë të tjerë belg, ku është për ti përsëritur

nga zemra, që kanë treguar dhe po tregojnë gatishmëri në të tyre për të ndihmuar dhe për të qenë sa më afër nesh. Mbrëmjen festive e udhëhoqën Fatos Syla dhe Arlinda Bislimi. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i LASH-it "Naim Frashëri" në Belgjikë, Dr. Agim Syla, i cili potencoi nevojën e masovizimit dhe institucionalizimit të shkollës shqipe në Belgjikë dhe bëri apel te prindërit shqiptarë, që ti dërgojnë fëmijët në shkollën shqipe, si një shtyllë e fortë, si një përmendore e çmueshme e kombit. Z. Nuhi Gashi, pasi uroi këtë manifestim, premtoi në të ardhmen edhe një përkrahje më të madhe për shkollën shqipe me MP në diasporë. Programi u shoqërua me disa recitime, këngë, një recital dhe egzekutime me piano nga nxënësit e shkollës shqipe të Sint-Niklaasit, të udhëhequra nga arsimtari i muzikës Shani Basha. Nxënësit të cilët morën pjesë në program ishin: Xhoana Memçaj, Endi Syla, Kron Basha, Edon Bislimi, Dion Syla, Arben Zymberi, Romansa Basha, Edona Zymberi, Etnike Fetahu, Erolinda Basha, Blin Syla, Arlinda Bislimi, Argolida Syla, Brenda dhe Leona Gashi si dhe Nadire Nuredini, e cila

lexoi dy poezi nga libri i saj i botuar "Stina shuan mallin". Përgjithësisht programi që dhanë këta fëmijë ishte i shkëlqyer dhe herë pas here morën duartkocitje nga të pranishmit e shumë të ishin. Në shenjë respekti për punën e bërë ndër vite, pranë kesaj shkolle, kryesia e LASH-it i nderoi me mirënjohje këta mesimdhënës: Shani Basha, Gazmend Hasani, Arjeta Ostergllava, Xhejnete Syla, për përkrahjen e dhënë shkollës shqipe në Belgjikë me mirënjohje u nderua edhe Nuhi Gashi nga MASHT e Kosovës, për ndihmë dhe përkrahje shkollës shqipe me mirënjohje u nderua edhe Bujar Memçaj, si dhe këngëtarë Mehdi Berisha, për gatishmërinë që ka treguar gjithmonë të ndihmojë dhe përkrah aktivitetet e shkollës shqipe dhe i cili edhe në këtë mbrëmje së bashku me orkestrën e tij i argëtoi të pranishmit.

Mirënjohjet i ndau Agim Syla, kryetar i LASH-it dhe Nuhi Gashi nga MASHT e Kosovës. Kryesia e LASH-it kishte paraparë një mirënjohje edhe për Mr. sci. Dashnim Hebibin. Të gjithë prindërit që ishin prezent ate ditë në këtë manifestim ishin të kënaqur

me programin që sollën fëmijët e tyre dhe falënderuan mësuesit dhe kryetarin e LASH-it që kanë punuar. Ndërsa mësuesit ishin ata më të lumturit, sepse tash nxënësit e tyre, jo vetëm që lexojnë bukur e rrjedhshëm, por edhe recitojnë e aktojnë. Kryetari i LASH-it z. Syla, pritke dhe përcillte bashkatdhetarët dhe falënderoi të gjithë që ishin prezent dhe njëherit, për portalin tonë, ndër të tjera tha: "Po shpresojmë shumë, që tash, me që e kemi edhe ministrinë e diasporës do të jemi më të fortë dhe do mendojnë për ne më shumë këndeje. Në shkollën plotësuese shqipe në Belgjikë kemi mësues dhe nxënës thuasë të të gjitha trevave shqiptare dhe të gjithë janë të përkushtuar që të japin kontributin e tyre të mundshëm, por natyrisht, se do na duhet ndihma edhe më e madhe nga ata bashkatdhetarë që ngurrojnë ti sjellin fëmijë e tyre në shkollën shqipe. Ju kisha lutur nga zemra, që ti sjellin fëmijët e tyre, sepse do të mësojnë gjëra të mira dhe padyshim se do të jenë më të lidhur me atdheun tonë, me shqiptarinë tonë.

Falë kontributit të pasohqë të këtyre veprimtarëve, fëmijët mërgimtarë po komunojnë bukur në gjuhën e tyre amtare, këndojnë e recitojnë e të duket vetja, se je në mes të Dukagjinit, Dardanës, Gjilanit, Preshevës, Drenicës, Pejës, Kumanovës, Podujevës,

■ Dossier

De jure: Albert Ajnshtajn ka qënë shtetas Shqipëtar

Në një nga rrugicat karakteristike të qytetit të Pogradecit, në lagjen Burima, në krahun e djathtë të kishës së vjetër të qytetit, ndodhet një vilë dykatëshe e zhytur në mes të një lulishteje dhe një kopshti me mollë dhe hardhi rrusi.

Është shtëpia e Bashove. Sapo futesh në shtëpinë e Bashove, do të ndeshesh me një portret të shkencëtarit të madh gjerman, Albert Ajnshtajnit, i cili është i vendosur në një nga pozicionet kryesore të shtëpisë.

Përqendrimi tek kjo foto nuk i habit pjesëtarët e familjes Basho, pasi ata na thanë se Albert Ajnshtajni ka qenë mik i madh i kësaj familjeje, madje shkencëtari i madh Albert Ajnshtajni, pas kontakteve të shumta në Vjenë me doktorin e famshëm Jani Basho (i cili pasi kthehet në Shqipëri punon si mjek personal i mbretit Zog), Ajnshtajni vjen në Shqipëri prillin e vitit 1931, kur ndiqej nga nazistët gjermanë, për shkak të origjinës së tij hebreje dhe më pas pajiset me një pasaportë shqiptare dhe të largohet me këtë pasaportë në drejtim të SHBA-së.

Po cilat janë faktet e kësaj nënshtetësie shqiptare të Albert Ajnshtajnit?

Në regjistrin e vjetër të vitit 1931, AKO 31, në faqen 53 /1, ndodhet ky shënim :

Sot më datën 10 prill 1931, u paraqit të zyrën e Bashkisë së Poradecit dr. Jani Bashua, i lindur më 1892 në lagjen Burima të Poradecit, i biri i Kozmait dhe Anastasisë, me profesion

mjek personal pranë naltmadhënisë së tij Zogu i Parë, i cili na jep garanci që Albert Ajnshtajni të bëhet qytetar i Poradecit. Kjo bashki e pajis me vërtetim dhe certifikatë Albert Ajnshtajnin, si banor të Poradecit në lagjen Burima.

Nëpunsi i Bashkisë Dhënsi i garancisë Reis Asllani Dr. Jani Basho

Dr. Jani Bashua, pas studimeve me rezultate të shkëlqyera në Vjenë, në vitin 1928 emërohet si mjek personal i mbretit Zogu i Parë. Në kujtimet e mbledhura nga nipi i tij, dr. Jovan Bashua, doktor Jani Bashua përshkruan me hollësi këtë moment:

Ka qenë 16 dhjetori 1930. Mbreti Zog, sapo hëngri darkë, i filluan disa dhimbje të forta barku. Pasi e viziton dr. Jani Bashua e këshillon mbretin që të shtrihej. Sipas Jani Bashos, mbreti Zog, prej dy vjetësh vuante nga një sëmundje zorrësh. Në këtë situatë u shtrua problemi që të vërtetohej diagnoza.

Pas dy ditësh, mbreti Zog thërret dr. Jani Bashon dhe i thotë që të përgatitej se do të shkonin së bashku në Romë për analiza të hollësishme. Dr. Jani Bashua i përgjigjet se ishte e drejta e tij, por nëse do t'i merrte mendim atij, duhet të shkonin të vizitoheshin në Vjenë.

Mbreti Zog ia miratoi propozimin dhe natën e 26 janarit, delegacioni i lartë shqiptar, me pasaporta me emra të falsifikuar për të ruajtur sekretin, u nis nga Durrësi me një kaçatorpedinier të flotës italiane, i cili të nesërmen i çoi në Trieste. Aty i priste treni

personal i Viktor Emanuelit, me të cilin mbërritën në Vjenë dhe më pas u sistemuan në hotelin Imperial.


Në Vjenë, dr. Jani Bashua takoi profesorët e tij dhe njëherazi dhe miqtë e tij, ndër të cilët, aktorin e famshëm Aleksandër Moisiu. Në takimin që ai pati tek shokët e tij dhe miqtë e ngushtë, ata i bënë një kërkesë:

Miku i tij, Albert Ajnshtajni, ishte në rrezik dhe kërkohet nga nazistët gjermanë si hebre dhe duhej të largohej, por e kishte të pamundur, pasi pasaportën e tij gjermane ia kishte sekuestruar gestapoja. Kështu, i thanë ata, meqenëse ju jeni mjeku personal i mbretit Zog, i thoni mbretit t'i japë një pasaportë shqiptare.

Pas vizitave të shumta dhe analizave që iu bënë mbretit Zog nga mjekët më të mirë austriakë dhe veçanërisht prof. Hollznecht-i, i cili i bëri më shumë se 30 radiografi për t'i përcaktuar diagnozën, në një moment pushimi, kur mbreti Zog po pinte kafe me dr. Janin në ambientet e hotelit, dr. Jani Bashua i bën kërkesën mbretit Zog që të pajiset shkencëtari Albert Ajnshtajni me pasaportë shqiptare, sepse jeta e tij është në rrezik nga nazistët.

Mbreti, pasi e dëgjoi deri në fund propozimin e mjekut të tij personal, i thotë, dakord, thuaji të vijë në Shqipëri dhe bëje t'i doktor Jani një herë pogradecar, si banues të Poradecit, më pas i japim një pasaportë shqiptare.

Në kujtimet e tij, thotë dr. Bashua, atë ditë kur i bëri kërkesën, mbreti ishte në formë të mirë dhe në mbrëmje ata shkuan së bashku në operën e Vje-



nës për të parë "Aidën" e Verdit. Por, kur dolën jashtë tek porta anësore ku po prisnin dy makina, mbreti Zog ishte në makinën e parë me truprojen e tij Llesh Topallajn dhe me Eqerem Libohovën. Sapo hipnim në makinë, kujton dr. Jani Bashua, u dëgjuan të shtëna armësh që na erdhën nga anash. Lleshi u rrëzua për tokë, ndërsa Eqerem Libohova ishte plagosur në pulpën e këmbës. Mbreti Zog u ul në gjunjë dhe mori pozicion dhe filloi që të shtjerë me pistoletën që kishte në brez andej nga erdhën krismat. Dr. Jani Bashua thotë se menjëherë shkova tek mbreti Zog dhe e pyeta se si ishte, por ai më tha shiko të tjerët se ai ishte mirë. Shkova tek Topallaj dhe pashë që ai kishte vdekur nga një plumb që e kishte zënë në arterien kardiake në qafë. Më pas i lidha këmbën Eqerem Libohovës për të ndërprerë hemorragjinë dhe u nisëm drejt spitalit.

Por, vazhdon dr. Jani Bashua, mbreti Zog e mbajtjti premtimin dhe një ditë ma rikujtoi që t'i thuash atij shkencëtarit që të vijë në Shqipëri dhe ta pajisim me

pasaportë shqiptare.

Po cilat janë dëshmitë e tjera që e vërtetojnë këtë?

Dr. Prof. Jovan Bashua, i cili është marrë me mbledhjen e kujtimeve të xhaxhait të babait të tij, Jani Basho, thotë për gazetën "Shekulli":

-Para se të vinte në Shqipëri, në qershor të vitit 2002, mbretëresha Geraldinë i dha një intervistë një gazetari anglez në revistën "Style", me titull "Kthimi i mbretëreshës", ku deklaroi se në Shqipëri kishte ardhur Albert Ajnshtajni dhe mbreti Zog e kishte pajisur me pasaportë shqiptare. -Së dyti, ish-bankieri i Bankës Kombëtare Shqiptare në kohën e Zogut, Ajeti Bega, i ka deklaruar ish-drejtorit të Fizikës Bërthamore, prof. Dr. Skënder Kojës, se Ajeti Bega kishte takuar personalisht në Bankën Shqiptare Albert Ajnshtajnin, në fillim të vitit 1931, kur Ajnshtajni i ishte paraqitur në Bankën Kombëtare Shqiptare për të kryer disa veprime midis Bankës Shqiptare dhe asaj gjermane. Por, nëpunësi i Bankës, Ajeti Bega, tregon se ai nuk e

ndihmonte dot, pasi banka e tyre veprime të tilla nuk kishte kryer në atë kohë. Atëherë, Albert Ajshtajni i ka thënë Ajeti Begës që t'i thoshte pak drejtorit të tij që e kërkonte Albert Ajshtajni për të sqaruar diçka.

Sapo Ajeti është futur në zyrën e drejtorit të bankës, i cili ishte italian dhe i ka thënë se e kërkonte Albert Ajshtajni, ai është ngritur më vrull nga karrigia dhe ka thënë "si ka mundësi të më kërkojë Albert Ajshtajni". Kush është ky, e kishte pyetur Ajeti Bega? Është një nga shkencëtarët më të mëdhenj të botës.

Më pas, Ajshtajni ka prishur një çek me një shumë të caktuar që ia kishte dhënë mbreti Zog si dhuratë. Sipas dokumenteve zyrtare, Albert Ajshtajni, në Bankën e Tiranës ka qenë më datën 9 prill 1931, ku ka kryer dhe veprimet e mësipërme.

Më datën 10 prill, dr. Jani Bashua ka marrë certifikatën me emrin e Ajshtajnit në Pogradec dhe më pas është plotësuar me ndërhyrjen direkte të mbretit Zog pasaporta me nënshtetësi shqiptare e Albert Ajshtajnit nga Ministria e Brendshme shqiptare. Sipas të dhënave zyrtare, Albert Ajshtajnit, pasaporta gjermane i ishte sekuestruar nga Gjermania naziste dhe sipas të dhënave zyrtare, Albert Ajshtajni ka shkuar dy herë në Amerikë në dhjetor të 1931-shit dhe në vitin 1932, me pasaportën shqiptare që e pajisi mbreti Zog, pasi nuk kishte pasaportë tjetër.

Vetëm në fund të vitit 1932, Albert Ajshtajni ka marrë edhe një pasaportë tjetër nga shteti zviceran, ndërkohë që të gjitha shërbimet e vitit 1931 dhe 1932 i ka kryer me pasaportën shqiptare.

Padyshim, thekson Dr. Prof. Jovan Bashua, populli ynë me të drejtë duhet të krenohet se ka shpëtuar mijëra hebrenj dhe midis tyre dhe shkencëtarin më të madh të shek XX, Albert Ajshtajnin.

<<<vijon nga faqe 5

të asaj periudhe që ne vetëm mund ti imagjinojmë sot. Është një paradoks i gëzueshëm dhe unik, Shqipëria është vendi i vetëm në Evropë ku në fund të luftës së dytë botërore kishte më shumë hebrenj se në fillim të saj». Kjo situatë mund të shpjgohet me rëndësinë e rolit të traditës shqiptare të mikpritjes dhe të besës sepse tradita shqiptare kërkon që të ftuarit duhen mikpritur e duhen mbrojtur. Por kjo gjë shpjgohet edhe nga tradita e tolerancës fetare që ka ekzistuar gjithmonë në vend

Sipas punimeve të fundit të Profesorit Saimir Lolja, të publikuara në gazetën Panorama të datës 25 janar 2010, i cili ka punuar me dokumente të publikuara nga historianët shqiptar Apostol Kotani dhe Shaban Sinani, numri i përgjithshëm i hebrenjve të shpëtuar mendohet të jetë 3614"

Dr. Najbor e vijoi konferencën e tij me shpalosjen e një serie të tërë dëshmi nga personalitete të ndryshme si dhe shembujsh që flasin mbi shpëtimin e hebrenjve në Shqipëri. Mes këtyre shembujve u fol edhe për rastin e gjenit të madh Albert Ajshtajni i cili kishte arritur të emigronte në USA falë një pasaportë shqiptare të dhënë nga autoritete e kohës, me kërkesë personale të mbretit Zog.

Pas prezantimit të Dr. Najbor, moderatori u dha fjalën të pranishmëve për të drejtuar pyetje dhe për të hapur debat. Mes diskutimit u vrenjt që për shumë nga të pranishmit këto informacione ishin krejtësisht të panjohura dhe që duhej bërë më shumë për përhapjen e tyre. Prezent në konference ishte edhe nipi i mbretit Zog, Z Skender Zogu i cili në fjalën e tij u ndal në traditën shqiptare të mikpritjes dhe të besës por edhe të tolerancës e harmonisë fetare që janë edhe faktorët kryesorë të fenomenit të shpëtimit të hebrenjve në Shqipëri.

■ Modë Pergatiti Grisela Kalesshi

Këshilla për flokë të shëndosha dhe të bukura

1. Sa më shumë që t'i lash flokët, ato do të jenë më të shëndetshme. Ajri i ndotur, yndyra dhe djersitja ndikojnë në flokët tuaja më shumë seç mendon. Flokët laji së paku dy herë në javë.

2. Në qoftë se flokët i lan pothuajse çdo ditë, përmbaju këshillës së ekspertëve të cilët thonë se shamponin duhet qitur në zverk, në tëmth dhe në ballë: tri pikat më të rëndësishme të cilat ndër të parat krijojnë yndyrë. Pastaj ngadalë formo shkumën me ujë të vakët në qoftë se ke flokë normale apo të yndyrshme, përkatësisht me ujë të ftohtë në qoftë se flokët i ke të thata. Shamponin lëre të veprojë disa minuta dhe pastaj flokët krihi me krehër me dhëmbë sa më të gjerë. Vetëm pasi t'i kesh bërë këto veprime laji flokët.

3. Harroje shprehinë e vjetër të fërkimit të tepërt të flokëve me peshqir pas larjes. Do të ndjehesh më komode, por edhe për flokët do të jetë më mirë në qoftë se i mbështjell vetëm me një peshqir të tharë. Peshqiri i mbledh pjesën më të madhe të lagështisë nga flokët. Pas një kohe merr edhe një peshqir të tharë dhe fërkoji me të butë flokët.

4. Intervali kohor për thar-



jen e flokëve me fen është midis 25 dhe 30 minutash. Në këtë mënyrë majat e flokëve nuk do të pësojnë.

5. Flokët me minival thaji me fen vetëm pjesërisht. Pjesën tjetër të tharjes lërja ajrit. Vetëm pas tharjes mund t'i krehësh dhe të bësh frizurën.

6. Kundër pëlçitjes së majave të flokëve ilaçi më i thjeshtë është regjeneratori shtëpiak nga të kuqtë e vezës dhe vaji i ricinës. Që të bësh regjeneratorin të nevojitet vetëm një vezë dhe vaji i ricinës. Vajin ngrohe pak dhe përzieje pikë për pikë me vezën, deri sa të krijohet si majonezë e vërtetë. Flokët mos i laj, por me regjenerator fërkoji majat e flokëve dhe mbështilli në një foli alumini, në kokë vër një kapelë plastike dhe mbaji sa më gjatë të jetë e mundshme. Pastaj flokët laji mirë!

7. Në qoftë se flokët i ke të ndara në mes, kij kujdes që kohë pas kohe vijën ta lëvizësh për një centimetër majtas apo djathtas, në mënyrë që të mos bëhet një vijë e theksueshme pa flokë.

8. Në qoftë se flokët të "shprishen", mos provo t'i rregullosh duke i krehur nga rrënja por nga majat, sepse në atë mënyrë më pak dëmtohen.

9. Në qoftë se shfrytëzon llakun për flokë, para se të shkosh në gjumë përherë duhet ta eliminosh nga flokët, duke i krehur mirë.

10. Në qoftë se dëshiron që frizura të jetë e shkëlqyeshme dhe natyrore, mos qit llak drejtpërdrejt në flokë, por në krehër apo në duar dhe me to spërkati flokët.

11. Në qoftë se nuk mundesh apo nuk arrin që t'i lash flokët, ndërkaq nuk dëshiron që të duken të yndyrshme, qitu flokëve beby pudër dhe pastaj krihi mirë. Gjithsesi kjo këshillë vlen vetëm për ato që kanë flokë të shkëlqyeshme.

12. Në qoftë se dëshiron që flokët tuaja ngjyrë gështenje të duken më të shkëlqyeshme dhe më të bujshme, laji në ujë në të cilin më parë ke zier lëvore arre (jo lëvozhga). Lëvoret ziej gjysmë ore dhe pastaj kulloji. Nga sasia e lëvoreve të cilat i ke përdorur varet nuanca e ngjyrës së flokëve.

■ **Kulture** Safet Kryemadhi



Elvira Dones

Piccola guerra perfetta

Récit d'une guerre qui a eu lieu

Kadaré. Des rumeurs qui instillent le doute sur l'innocence des victimes et trouvent des circonstances atténuantes au crime commis. L'indulgence envers les tortionnaires vaut ainsi indifférence à l'égard des souffrances d'un peuple.

Alors, face à cette confusion, la grande littérature remet en ordre le réel. Elle est conscience en éveil quand les bonnes consciences s'accommodent du pire. La fiction réunit les mots simples des martyrs et les témoignages de ceux qui avaient le tort, par leur malheur nu, de contredire tous les raisonnements sophistiqués sur la souveraineté étatique inviolable, les responsabilités partagées de la guerre ou l'incompréhensible imbroglio balkanique. « Piccola guerra perfetta » (« Petite guerre par-

faite ») est le titre, par antiphrase, du puissant roman d'Elvira Dones, récemment publié en italien par l'éditeur Einaudi. Il a, comme les autres récits de Elvira Dones, pour personnage central et blason la femme albanaise. Roberto Saviano, l'auteur du célèbre « Gomorra », confie dans la préface avoir compris à la lecture de ce roman, « qu'il n'existe pas une guerre racontée vraiment si l'on n'entend pas ce que racontent les femmes qui l'ont vécue ».

Car pour atteindre l'objectif stratégique de Belgrade - nettoyer le Kosovo de la présence albanaise - la terreur de masse et les abjections de toutes sortes contre les femmes constituaient une tactique militaire en tant que telle. Les milices et autres chiens de guerre serbes avaient pour feuille de route

l'humiliation de tout un peuple. Treize milles morts, vingt milles femmes outragées, selon les témoignages rassemblés par les travailleurs sociaux au Kosovo: « Piccola guerra perfetta » est un énoncé impitoyablement documenté de l'horreur vécue au jour le jour par les Albanais. La folie nationaliste serbe s'y déchaîne contre la jeunesse, le rêve, l'espérance, la solidarité, la féminité ; contre ce qui fait l'humanité d'une nation. Le roman d'Elvira Dones est indispensable car il porte la mémoire des temps difficiles. Il faut en espérer rapidement la traduction dans d'autres langues. Un chapitre de « Piccola guerra perfetta » est proposé ici en version française.

Elvira Dones, Piccola guerra perfetta, Giulio Einaudi editore, 2011, 166 pp, 17 euros

« Piccola guerra perfetta » est un énoncé impitoyablement documenté de l'horreur vécue au jour le jour par les Albanais.

La littérature c'est ce qui sauve quand on veut tout oublier. La guerre du Kosovo, par exemple, et l'oeuvre sinistre des bourreaux serbes contre les femmes et les jeunes filles albanaises. Ce n'est pas le silence qui est ici à craindre mais plutôt un bruyant « orchestre » de rumeurs, pour reprendre le mot juste de


Le fleuve sans nom

Ils viennent avec une torche. Trois miliciens et une femme. Ils passent la lampe sur les visages. -Celle-ci, -dit la Serbe, - elle a vingt ans. Elle est blonde, elle a deux tétons... -Et comment tu sais qu'elle est blonde? Je ne vois rien. -Il fait nuit, non? Fais-moi confiance. Blerime s'est couverte de paille. Tante Dardana aussi. Ils emportent une fille à droite de Blerime et, tant qu'ils y sont, un Serbe traîne aussi dehors le frère de la malheureuse, auquel il manque un bras. Une bombe l'a arraché il y a quelques jours mais lui est resté en vie malgré le sang perdu: un océan. La soeur lui avait embrassé le moignon et lui avait murmuré durant toute la nuit: je te prends la fièvre, Alban, ne meurs pas, c'est seulement un bras, la belle affaire, « shpirt i motrës ». C'est seulement un bras. Et il est resté en vie. Il délirait en chantant. Puis il pleurait. Les autres le conjuraient de ne pas lâcher un mot.

La soeur d'Alban sans le bras s'appelle Bukurije. Maintenant ils les portent tous les deux dehors, Bukurije et Alban. Quelques minutes plus tard on entend les cris de la fille, dans le jardin; elle hurle à en déchirer le monde. Mais ne comprennent-ils donc pas, les hommes, que si une femme hurle comme ça il vaut alors mieux la laisser en paix? Si tu l'entends, ce cri, peut-être qu'il te viendrait une réponse du fond de la nuit, des nuits. Et tu t'arrêtes. Tu abandonnes les armes au beau milieu de la rue et tu retournes à ta maison faire autre chose, peut-être regarder un film, ou manger un plat chaud, ou t'asseoir dehors pour écouter le silence descendre dans la paix sainte, pense Blerime. Mais ces Serbes-ci n'ont pas la sensibilité de certaines choses ; maintenant elle est en colère contre eux. Et même si elle pense que quelque chose manque dans leur coeur, cela ne la fait éprouver aucune sympathie. Elle est confuse. Confuse et claire en même temps. Tante Nita dirait

Traduction: **Safet Kryemadhi**
« lucide » au lieu de « claire ». Tante Nita et Rea et la professeuse Besa Ajeti parlent tellement bien. Elles ont l'allure, le visage de femmes qui savent. Ces derniers jours, dans l'exode, Blerime a mûri ses projets. Avant elle savait qu'elle aurait fait comme tante Nita: vivre seule et enseigner. Mais maintenant cela ne lui suffit plus. Il faut faire plus avec les mots. Elle écrira, racontera ce qui est en train de leur arriver dans cette étable. Si elle savait y faire avec les notes elle mettrait en musique cette horreur; il y a certainement moyen. Les Schubert, les Beethoven, les Mozart, qu'écoute tante Nita, ont raconté de grandes choses avec la musique; mais à dire vrai, elle, la musique... Elle doit utiliser les mots. Mais pas la voix, la voix n'a pas de sens. Tout le monde parle, cela n'a pas de sens. Elle écrira et le cachera quelque part, comme ça quand elle sera morte quelqu'un le trouvera et le lira. Parce qu'il n'y a pas de doute qu'elle mourra. Et ces pensées

qu'elle est en train de faire, cachée sous la paille pour ne pas entendre les cris de Bukurije à l'extérieur, étaient sûrement déjà en elle auparavant. La guerre les a seulement faites sortir. Elle ôte un brin de paille de la narine; au moins la guerre doit servir. Elle te fait comprendre les choses. Ou te rend complètement dingue. Elle pense, au contraire de Fatmir qui semble avoir perdu la tête, même s'il ne dit rien et fait l'endormi. Il a de la paille ensanglantée collée un peu partout sur les cheveux et le visage. -Pourquoi Allah nous a abandonnés ainsi? - soupire tante Dardana sans s'adresser à personne en particulier. - Qu'avons nous fait au bon Dieu? Blerime caresse la tête de son frère mais lui ne bouge pas. Fatmir agit toujours comme ça, quand quelque chose lui déplaît, il fait l'endormi. Il se replie complètement en lui, se verrouille de l'intérieur et il n'y a pas moyen de l'en faire sortir. Maman Hana roule alors les yeux au ciel. Mais Blerime parvient de temps à autre à le tirer dehors, et de cela elle est fière. En plus du football, Fatmir aime



les enfants kosovars du quartier étaient convaincus que les Serbes avaient commencé la guerre. Et les enfants serbes disaient que non, c'était Milosevic qui avait commencé et pas les Serbes. Mais il n'y avait pas beaucoup de logique là-dedans : quelqu'un ne peut pas faire la guerre seul, il ne peut pas être soldat et général et policier et venir au Kosovo pour tout brûler. Si quelqu'un fait le fou et que les autres ne sont pas d'accord avec lui, ils le lui disent, ils ne le suivent en aucun cas, ils lui disent franchement qu'il est en tort et le renvoient, et ils en installent un plus raisonnable.

Cette discussion avait fini par des coups entre les enfants du quartier. Quand par la suite les familles serbes s'en allèrent, effrayées, les enfants d'ethnie albanaise n'avaient éprouvé aucun regret. Qu'ils s'en aillent où ils veillent, ceux-là.

La pauvre Bukurije là dehors est toujours vivante, elle pleure encore et proteste, mais elle n'a plus la force de hurler. Les hommes grognent et gémissent et font gicler quelque chose qu'ils nomment avec des vilains mots. A présent Fatmir ouvre les yeux, regarde Blerime et lui dit :

-Je ne les laisse pas t'emmenner, Bler.

-D'accord.

-Celui qui arrive le premier chez l'oncle Arlind, lui raconte comment l'autre est mort, d'accord ?

-Tu ne vas mourir, frère.

-« T'kam loçkë. » - Blerime sourit de toutes ses dents. C'est une expression de femmes, les mâles ne disent pas ces choses.

-Tu ne mourras pas, « shpirt i motrës », et je te promets que je raconterai tout, même si c'est dans mille ans.

La sœur a toujours parlé de façon étrange, c'est pourquoi Fatmir acquiesce : dans mille ans ils se rencontreront, Bler et Fatmir et maman Hana et papa Bexhet. Pas sur cette terre, pas dans ce Kosovo mais quelque part ailleurs.

-Tu ne vas mourir ! conclut Blerime. - Crois-moi.

Et les Serbes retournèrent dans

l'étable.

-Celle-là, - dit la Serbe qui leur sert de guide, désignant tante Dardana, prenez celle-là.

La tante hurle, se démène, prie, ils lui frappent la tête avec un fusil, la traînent comme un sac de patates en vomissant des paroles horribles, et tandis qu'ils la traînent l'un d'eux lui déchire le pull avec la baïonnette qui emporte, avec le pull, des morceaux de chair. Puis le feu éclate. De quelque part à l'extérieur du village on jette des bombes, on tire et on entend des voix en albanais.

-Ce sont les nôtres, - dit quelqu'un, - ce sont les nôtres, nous sommes sauvés.

Quelques hommes encore valides cherchent à fuir mais la porte est fermée de l'extérieur. Les fenêtres sont très en hauteur et trop petites, seuls des corps fins pourraient s'y glisser.

-Vas-y, implore Blerime à son frère, - tu es mince, Essayons.

-Sans toi je ne vais nulle part. Je t'en supplie.

Fatmir lui flanque une baffé, la secoue ; les décisions c'est lui, l'homme, qui les prend et elle doit se taire. Un garçon tente à vrai dire la fuite, mais à peine au sommet il est touché d'une rafale de l'extérieur et tombe en arrière sur le compagnon qui lui prêtait l'épaule, et dans le bref instant de la chute il trouve le temps de mourir. Les autres l'oublient aussitôt et s'agitent à la recherche d'une autre issue pour fuir, sans succès. Dehors on combat durant dix minutes ou peut-être plus.

Blerime dispose les cadavres l'un sur l'autre, cherchant du mieux qu'elle peut à les appuyer au mur. Seule une vingtaine de gens ou moins sont restés en vie, les morts doivent être au moins le triple. La bataille s'achève. Les Serbes ont eu le dessus et quelqu'un dit en albanais : « Burra sot u pa, kthehena nesër prapë ! »

Un silence relatif est tombé, puis une radio crachote quelque chose en serbe, probablement un ordre, et les miliciens se mettent à courir à droite et à gauche, ramassent des armes et d'autres objets, font démarrer le moteur des camions et avant de s'en aller jettent à l'intérieur de l'étable une chose qui explose en flammes. Les camions partent à toute gomme, les gens pris au piège trouvent la force de hurler et Blerime ordonne à Fatmir :

-Saute par la fenêtre. Va-t-en maintenant, je l'ai promis à maman.

Un vieux qui a vu Blerime entasser les cadavres poursuit le travail de la petite fille, construisant une sorte d'échelle pour rejoindre la sortie. Il ne reste plus que deux enfants de l'âge de Blerime, Fatmir et le vieux, deux femmes enceintes ; l'une éprouve les douleurs de l'accouchement mais personne ne s'intéresse à elle et à ses gémissements, si bien qu'elle est perdue. Les enfants aident le vieux ; Fatmir fait un essai et arrive à la hauteur de la fenêtre. Il retombe. Un des cadavres n'en est pas un parce qu'il râle, mais ils ne peuvent pas l'extraire de la construction improvisée car il se trouve quelque part au milieu et qu'il n'y a pas de temps.

-Sors, grand-père, -dit Fatmir au vieux, - vas-y, on peut y arriver.

-Je le disais pour vous, moi je reste avec ma femme qui est morte hier. Toi, porte ceux-là dehors, porte-les dehors.

Le vieux semble fou ; Blerime tire Fatmir par la manche, lequel n'a pas le temps de le remercier ; Blerime le pousse sur l'amoncellement de cadavres, le feu est dans leur dos, ils se jettent dehors chacun leur tour.

Et là dehors il y a tante Dardana, criblée de coups, mais elle ne le voit pas car elle a pensé, à bon escient, de fermer les yeux pendant qu'elle mourait, autrement un souvenir pénible serait resté, pense Blerime. Un souvenir pénible.

Et ils fondent en larmes, tandis que l'étable est envahie par le feu, et eux courent vers le bois. Ils courent et ils pleurent, et ils entendent maintenant hurler la femme qui était en train d'accoucher à l'intérieur, hurler plus fort que tous les autres, vivants et morts, et pendant quelques temps elle les poursuit de ses cris.

Les enfants sont cinq, non, six, ils s'arrêtent seulement quand ils se trouvent devant un fleuve, un grand fleuve. Ils ne savent pas quel est ce fleuve et ils ne se le demandent même pas.

Ils le regardent étinceler et se jettent à terre. Et l'eau, dans toute son éblouissante splendeur, est la dernière chose que Blerime retiendra dans les souvenirs de cette journée.

(pages 95-101)

les mathématiques, c'est le meilleur de l'école. Il veut devenir un scientifique, ce qui en « fatmiresque » se traduit par: j'irai dans une université importante.

« Il y en a une appelée MIT, qui se trouve à Boston, en Amérique, c'est là que je veux étudier, tu comprends ma soeur? »

« Toutes ces choses difficiles, soupirait-elle. Les nombres?! »

« Parce que tu peux jouer au football jusqu'à un certain point, répondait-il sagement, mais quand tu es vieux tu ne peux plus le faire, ce sont les lois de la nature, tu comprends? »

Bien sûr qu'elle comprenait, les footballeurs doivent être jeunes.

« C'est pourquoi je veux aimer deux choses dans la vie, et pas seulement une! J'ai décidé d'aimer les mathématiques et le football. Et toi, évidemment, mais tu n'es pas une chose, tu es une personne. »

Fatmir est le meilleur ami de Blerime, même si c'est un garçon et qu'habituellement les mâles restent avec les mâles. Mais Fatmir ne s'ennuie pas à rester avec elle. Ils parlent beaucoup. Sans doute est-il son ami parce que maman et papa sont les meilleurs amis entre eux, et il est naturel alors pour le frère et la sœur de les imiter.

A la différence de Blerime qui est un peu exigeante en amitié, Fatmir est facilement sociable. Concrètement presque tous les enfants du quartier sont ses amis, même les Serbes, avant qu'ils quittent Prishtina pour fuir cette guerre en train d'arriver. A dire vrai,

STUDIO



EAGLE



Studio "EAGLE" ju ofron:
 Shërbime profesionale; Kamera, foto, muzikë(DJ).
 Dasma, fejesa, syneti, ditelindje,
 videoklipe & evenimente të tjera...
 Foto & video montazhe.
 Design; kartvizita, kalendar, reklama, logo etj...

+32 486 064 120 / +32 485 509 444

www.studioeagle.com



Studio Eagle u jep jetë kujtimeve tuaja më të bukura!

